



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 83, datë 21.05.2025

**PËR
MIRATIMIN E PËRSHTATSHMËRISË SË SHOQËRISË “SIGAL UNIQA INVEST”
SH.A. DHE FONDEVE SIGAL MAX PENSION DHE SIGAL PRO PENSION ME
KËRKESAT E LIGJIT NR. 76/2023 “PËR FONDET E PENSIONIT PRIVAT” DHE
RREGULLOREVE NË ZBATIM TË TIJ**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 202, të Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat” dhe neneve 62, dhe 63, të Rregullores nr. 1, datë 31.01.2024 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat dhe depozitarit të fondeve të pensionit privat të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e përshtatshmërisë së shoqërisë “Sigal Uniqa Invest-shoqëri administruese e fondeve të pensionit privat dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive” sh.a., me kërkesat e Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat” dhe rregulloreve në zbatim të tij.**
- 2. Miratimin e përshtatshmërisë së fondit të pensionit privat me pjesëmarrje të hapur Sigal Max Pension, me kërkesat e Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat” dhe rregulloreve në zbatim të tij.**
- 3. Miratimin e përshtatshmërisë së fondit të pensionit privat me pjesëmarrje të hapur Sigal Pro Pension, me kërkesat e Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat” dhe rregulloreve në zbatim të tij.**
- 4. Ngarkohen Drejtoria e Licencimit dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**